

Që nga dita e arrestimit të hoxhallarëve njerëz të shumtë kanë shprehur pakënaqësinë e tyre për këto arrestime. Këtë e kanë bërë në forma të ndryshme duke rrëfyer përvojat dhe të mirat që kanë pasur nga këta hoxhallarë. Ajo që më së tepërmi vërehet janë faktet e shumta për kontributin e hoxhallarëve në ruajtjen dhe kultivimin e stabilitetit në shoqëri e aspak e kundërta, për të cilën ata po akuzohen.

Një tregim shumë interesant na e sjell një dëgjues i Radio Pendimit. Ai gjatë një inkuadrimi në një emision në këtë radio, derisa shpreh pakënaqësinë e tij për burgimin e hoxhallarëve, tregon se si këshillat e hoxhës dr. Shefqet Krasniqi kanë qenë vendimtare që ai të mos bëj vetëvrasje.

“Njëri nga këta hoxhallarë, dr. Shefqet Krasniqi, pasi që më ka vdekë një djalë dhe përshkak të varfërisë së skajshme unë kam pas me ba vetëvrasje, me këshillat e doktorit (dr. Shefqet Krasniqi) unë sot jam gjallë”, thotë dëgjuesi.

Dr. Shefqet Krasniqi i kishte thënë se vetëvrasja nuk është zgjidhje, dhe e kishte këshilluar që ta luste Allahun dhe se Ai do t'i dhuroj të mira dhe do t'ia rregulloj jetën.

“Ai më ka këshillue, më ka thanë o vëlla nuk është zgjidhje me ba vetëvrasje, Allahu është ai që ka me të dhanë edhe ty sikur krejtve që ju ka dhanë dhe ka me tu ndrqë jeta. Banë sabër, banë dua. Me këshillat e doktorit (dr. Shefqet Krasniqi), unë sot kam tre fëmijë, kam shtëpi dhe kam jetë normale elhamdulillah”, përfundon tregimin e tij dëgjuesi i Radio Pendimit.

Dr. Shefqet Krasniqi së bashku me disa hoxhallarë të tjerë u arrestua më 17.09.2014. Ditë më parë atij i është vazhduar paraburgimi deri më 17.10.2014.

Deri më tani janë liruar tre nga hoxhallarët e arrestuar, hoxhë Ekrem Avdiu dhe Enis Rama nga Mitrovica dhe hoxhë Enes Goga nga Peja./Shembulli/

[youtube height="400" width="100%" align="none"]<https://www.youtube.com/watch?v=SnSs7Nnpn2E>[/youtube]